

A.A.nr.135/2014

Datë 13.06.2014

NDËRPRERJA E AKTIVITETIT ILEGAL TË HULUMTIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË LËNDËVE MINERARE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Neni 2 i Ligjit, nr./03/L-163, për Miniera dhe Minerale, rregullon fushëveprimin e këtij Ligji ,dhe përcakton se ky ligj zbatohet për të gjitha aktivitetet që përfshijnë hulumtimin, shfrytëzimin dhe/ose pasurimin e lëndëve Minerale në Republikën e Kosovës.

Neni 70 rregullon aktivitetet e jashtëligjshme të hulumtimit shfrytëzimit dhe aktivitet e veçanta, dhe ndërmarrjen e masave ndaj ushtrueseve të aktivitetit të hulumtimit apo shfrytëzimit të personave pa licencë apo leje të KPMM.

Sipas nenit 70.3 të Njëjtij ligj parashihet se nëse personat ose punëdhënësi i tyre(nëse kanë punëdhënësi),nuk posedon leje apo licencë nga KPMM, zyrtarët e policisë i arrestojnë personat në fjalë të cilëve më pas u shqiptohet gjoha administrative e përcaktuar sipas nenit 79 par.2 të këtij ligji ,dhe dënimet penale sipas nenit 80 të këtij ligji. Për veç kësaj inspektori konfiskon të gjitha mjetet punuese dhe mineralet e nxjerra që gjendjen në vendin e rastit.

Nga arsyetimi

Paditësi ka ushtruar padi për konflikt administrativ kundër të paditurit, me objekt anulimin e aktit administrativ-Aktvendimit të KPMM-së-Komisionit për ankesa, K.A.nr.000/12, të datës .04.2012,me të cilin i është refuzuar ankesa me nr. protokoll nr.000, e dt. 20.01.2012, kundër Vendimit të KPMM, për ndërprerjen e aktivitetit ilegal Minerar dhe konfiskimin e mjeteve të punës dhe mineraleve nr.000/2012, të datës 13.01.2012, sepse me datë 13.01.2012, në vendin e quajtur "...” në Prizren , është hasur, duke transportuar me kamion transportues Mercedes 10 m3,zhavorr në mënyrë ilegale dhe për këtë i është ndërprerë ky aktivitet ilegal dhe i është konfiskuar kamioni i cekur më lartë dhe rëra, në sasi prej 10m3, si në vështrim të nenit 70 par.3 të Ligjit për Miniera dhe Minerale.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas padis së paditësit pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit publik dhe procedimit me palët dhe pas administrimit të provave relevante me aktgjykimin e atakuar me ankesë e refuzon si jo të bazuar kërkesëpadinë e paditësit për anulimin e Vendimit të paditurës KPMM,nr.000/12 të dt.02.04.2012, me arsyetim se paditësi pa Licencë të vlefshme, me automjetin transportues të cekur më lartë ka bërë operim minerar duke transportuar zhavorr në kundërshtim me nenin 70 par.1 dhe 3 të Ligjit për Miniera dhe Minerale ,ligji nr.03/L-136.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar i autorizuari i paditësit avokat F. G., i cili e konteston ligjshmërinë e aktvendimit të atakuar, për shkak të cenimit të ligjit dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, në arsyetim ndër të tjera thekson; se paditësi kryen veprimtari legale si auto transportues në bazë të certifikatës së biznesit, se ditën kritike ka qen duke transportuar rërë për nevojat e tij personale dhe se të njëjtën e ka blerë nga “Dili Commerce” në Landovicë, se paditësi nuk ka hulumtuar dhe nuk ka operuar me zhavorr në mënyrë ilegale, se konfiskimi i kamionit është jo ligjor dhe arbitrar dhe pronësia në sende gëzon mbrojtje ligjore dhe kushtetuese, propozon që gjykata e shkallës së dytë të aprovoj ankesën dhe të anuloj aktgjykimin e shkallës së parë.

Organi i paditur Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale Prishtinë, në përgjigje në ankesë të paditësit, mbetet pranë thënieve në aktvendimin e kontestuar KA nr.901/12, të dt.02.04.2012, e konteston ankesën si të pabazuar dhe propozon që e njëjta të refuzohet dhe të vërtetohet aktgjykimi i shkallës së parë.

Gjykata e Apeli e Kosovës vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44, par. 1, neni 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), dhe neni 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA në drejtim të thënieve në ankesë, përgjigjes në ankesë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjen se;

Ankesa është e pabazuar.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë nga se sipas vlerësimit të kolegjit janë administruar prova të mjaftueshme për vendosjen në mënyrë të drejt dhe meritore të çështjes nga të cilat vërtetohet se paditësi si operues ilegal ka bërë shfrytëzimin e mineraleve dhe është hasur duke e transportuar të njëjtën në mënyrë kundërligjore në lagjen "...a" në Prizren ,dhe me këtë veprim ka kryer vepër e cila parashihet me nenin 70 të Ligjit për Miniera dhe Minerale, e që sipas nenit 70.3 të njëjtit ligj parashihet se për veç gjobave administrative dhe dënimit penal bëhet edhe konfiskimi i të gjitha mjeteve punuese dhe e mineraleve të nxjerra që gjenden në vendin e rastit, andaj janë të pa qëndrueshme thëniet në ankesën e ushtruar "se konfiskimi i automjetit nga ana e KPMM është i kundërligjshëm dhe jo i drejtë", pasi që kjo çështje është e rregulluar me dispozitat e cekura më lartë, në të cilat janë bazuar vendimet e organit administrativ dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë .

Nga aktgjykimi i shkallës së parë dhe vendimi i të paditurës konstatohet se me rastin e ndaljes dhe legjitimit nga inspektorët dhe policia, drejtuesi i kamionit të subjektit që transportonte zhavorrin nuk ka poseduar dokumentet e nevojshme(Licencë ose Leje të lëshuar nga KPMM), për shfrytëzimin dhe transportimin e lëndës e cila është objekt i veprës nga të cilat do të dëshmohej se operimi minerar nuk është i kundërligjshëm si pretendohet në ankesën e ushtruar.

Kolegji gjithashtu gjen se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje të dispozitave të Ligjit për Konflikte Administrative, të cilat gjykata i heton sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 49 të LK-së dhe nenit 194 të Ligjit për procedurën kontestimore, dhe as me shkelje të cilat pretendon ankuesi, sepse procedura në gjykatë të shkallës së parë është zhvilluar ashtu si parashihet me ligj.

Mbi këtë gjendje të fakteve, kjo gjykatë konstaton se në këtë çështje administrative drejtë është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit, andaj thëniet e ankesës nuk i aprovoi dhe i vlerëson të pa ndikim për vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga ana e organeve administrative.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 46, par. 2 dhe 49 të LKA-së, dhe neni 200 të Ligjit për procedurën kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

AKTGJYKIMI I GJYKATËS SË APELIT PRISHTINË
A.A.nr.135/2014, datë 13.06.2014

